



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

Numri i lëndës: 2021:275808

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05411003

**CP.nr.562/21**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Hatixhe Begaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B. K., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bestar Kolgeci, avokat nga Prizreni Rr. “De Rada” nr.6, kundër debitorit Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit -DKA, e përfaqësuar nga avokati publik i komunës Mujë Sahitaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, kundër Aktvendimit për lejimin e përmbarimit CP.nr.562/21 të datës 13.05.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datën 05.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës, Drejtoria Komunale e Arsimit, i ushtruar kundër Aktvendimit të kësaj gjykate, CP.nr.562/21 të datës 13.05.2022 për lejimin e përmbarimit.

II. MBETET NË FUQI Aktvendimi CP.nr.562/21 i datës 13.05.2022, me të cilin është lejuar përmbarimi, për shumën e përgjithshme të borxhit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtave) për vitin 2020, në shumë prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) Euro për 185 ditë pune, sipas Vendimit Nr.384/2021 të datës 31.08.2021, të lëshuar nga MFPT / Inspektorati i Punës - Prizren, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në vlerë prej 138.00 (njëqind e tridhjetë e tetë) Euro.

III. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për kompensimin e shpenzimeve përmbarimore mbi shumën e aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

**A r s y e t i m**

Kreditori B. K., përmes të autorizuarit të tij Bestar Kolgeci, avokat në Prizren, në këtë gjykatë ka parashtruar propozim për përmbarim në bazë të vendimit administrativ, sipas të cilit ka kërkuar përmbarimin e shumës së borxhit në emër të shpenzimeve të ushqimit (shujtave) në punë, për vitin 2020, në shumë prej 370.00 Euro për 185 ditë pune, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Kjo gjykatë e ka lejuar përmbarimin sipas Aktvendimit CP.nr.562/21

të datës 13.05.2022. Ndaj vendimit për lejimin e përmbarimit debitorja brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim.

Debitorja përmes përfaqësuesit avokatit publik të komunës Mujë Sahitaj, në prapësimin e dt.03.06.2022 ka theksuar se nuk e konteston vlerën e borxhit, mirëpo e konteston këtë propozim i cili është lejuar nga gjykata sipas Vendimit të Inspektoratit të Punës si i pabazuar, dhe se ky vendim është atakuar nga Drejtoria e Arsimit në Malishevë në shkallë të dytë të inspektoratit të punës dhe i njëjti ende nuk ka vendosur lidhur me ankesën dhe se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me procedurë përmbarimore sipas dispozitave të LPP-së neni 29 pasi ky vendim është i atakuar, duke i propozuar gjykatës që prapësimin ta aprovojë si të bazuar dhe ta anuloj vendimin për lejimin e përmbarimit, si dhe t'i refuzojë shpenzimet përmbarimore lidhur me këto raste.

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, Av. Bestar Kolgeci, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pala debitore është thirrur në çështjen se vendimi i Inspektoratit të Punës është i paligjshëm për arsye se e ka nxjerrë organi jokompetent dhe jo i bazuar në ligj. Gjykata përmbarimore nuk mund të lëshohet në atë se a është kompetent inspektorati për ta nxjerr një vendim të tillë apo jo dhe për ta vlerësuar nëse është i drejtë apo jo, ky vendim është i ekzekutueshëm. Prapësimi i debitores nuk është i mbështetur në asnjë nga kushtet e parapara me nenin 71 të LPP-së, andaj si i tillë duhet të refuzohet. Shpenzimet e përgjigjes në prapësim i ka kërkuar në dyfishin e shpenzimeve për përmbarim në lartësi prej 312 euro.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, vlerësimin të prapësimin të debitores, gjeti se, prapësimi i debitores është i pabazuar dhe si i tillë është refuzuar.

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën përmbarimore (Nr.04/L-139, më tej LPP) në nenin 21 përcaktohen bazat juridike për caktimin e përmbarimit: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 22 par. 1 nënpar. 1.2 përcaktohet se: *“1. Dokumente përmbaruese janë: 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi (më tej: ujdia)”*, ndërsa neni 23 par. 2 e përcakton se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”* Gjykata me verifikimin e Vendimit Nr.393/2021 të datës 02.09.2021, të lëshuar nga MFPT / Inspektorati i Punës - Prizren, në të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, vërtetoi faktin se ky vendim e ka cilësinë e dokumentit përmbarues, është *“titulus executionis”*, përkatësisht ka titull ekzekutiv, me arsyetimin se këtë vendim e ka nxjerrë organi shtetëror Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, i cili ka autorizime publike, vendimi është nxjerrë në procedurë administrative, ka të përcaktuar kreditorin, debitorin, shumën e borxhit, kohën e përmbarimit dhe është i ekzekutueshëm, andaj i përmbarim kushtet sipas nenit 24 par. 3 të LPP-së, ku përcaktohet se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*

Gjykata gjeti se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë sa i përket asaj se nuk kemi të bëjmë me procedurë përmbarimore sepse vendimi i Inspektoratit të Punës është i atakuar në shkallë të dytë dhe se ende shkalla e dytë nuk ka vendosur lidhur me ankesën, pasi që sipas konkluzionit të Gjykatës së Apelit me shenjë GJ.A.797/21 të dt. 21.10.2021, konkludohet se *“Duhet të lejohet ekzekutimi i vendimeve të Inspektoratit të Punës edhe nëse iu mungon vula ekzekutueshmërisë (përmbarueshmërisë), me kusht që në këto vendime të ceket se ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit”* e që në rastin konkret vendimi i Inspektoratit të Punës me nr.384/2021 të datës

31.08.2021 në pikën III të dispozitivit e parasheh se “Ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektoratit të Punës, nuk e shtynë ekzekutimin”.

Gjykata kishte parasysh edhe pretendimet tjera të debitorit mirëpo i mori si jo relevante në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit rigoroz formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e lartcekura.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e ka refuzuar prapësimin e debitores dhe e ka lënë në fuqi vendimin për lejimin e përbarimit, me arsyetimin se prapësimi nuk ka asnjërin nga elementet që parasheh neni 69 i LPP-së, ndërsa dokumenti përbarues i përmbush të gjitha elementet e dokumentit që ka titull ekzekutiv konform nenit 21, 22 dhe 23 të LPP-së, ndërsa debitorja me asnjë provë nuk e ka argumentuar të kundërtën. Nga arsyet e potencuara gjykata vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore si në pikën II dhe III të dispozitivit, konform nenit 13 par. 4 dhe nenit 17 të LPP-së, lidhur me nenin 449 dhe 452 të LPK-së, duke obliguar debitorin që kreditorit në emër të shpenzimeve për propozim për përbarim t’ia paguajë shumën prej 117.00 euro dhe për taksë gjyqësore shuma prej 21.00 Euro, sipas Tarifës së Avokatëve OAK-së, numri tarifor 6. Ndërsa kërkesa për kompensimin e shpenzimeve lidhur me përgjigjen në prapësim në shumën prej 312 euro është refuzuar, për shkak se e njëjta nuk konsiderohet parashtrësë në kuptim të nenit 99 të LPK-së, nenit 6.1 të OAK-së, si dhe nenit 2.4 të UA Nr.01/2017, të datës 15.03.2017, për unifikimin e taksave gjyqësore.

Nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 21, nenit 22 par. 1 nënpar. 1.2, nenit 23 par. 2, nenit 24 par. 3 dhe nenit 13 par. 4 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP-së).

**GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**CP.nr.562/21 dt.05.03.2024**

**Gjyqtarja**  
**Hatixhe Begaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda afatit prej shtatë (7) ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.